

L I G J
Nr. 9481, datë 16.2.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9418, DATË 20.5.2005 “PËR SIGURIMIN
SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

(Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.2.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.2.2007)

Neni 2

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

1. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është 50 për qind e pagës referuese.

2. Për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim, mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës referuese.

3. Masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se:

a) gjashtëfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për ushtarakët që mbajnë gradën gjeneral;

b) pesëfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për ushtarakët që mbajnë gradën kolonel;

c) katërfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për ushtarakët që mbajnë gradat major dhe nënkolonel;

ç) trefishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për të gjithë ushtarakët e tjerë.

4. Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndërpritet kur ushtaraku përfitues rikthehet në shërbimin aktiv.

5. Në rast të punësimit të ushtarakut përfitues në sektorin publik, masa e përfitimit nga pensioni i parakohshëm, për vjetërsi shërbimi, do të jetë sa një pension bazë në shkallë vendi.

6. Në rast punësimi në vende të tjera pune gjatë kësaj periudhe, masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të jetë deri në kompensimin e pagës, mbi të cilën është llogaritur kjo pagesë dhe jo më shumë se masa e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, por, në çdo rast, jo më pak se masa e pensionit bazë në shkallë vendi.

7. Periudha, për të cilën ushtaraku përfiton pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni të plotë pleqërie, sipas pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kontributi për këtë kategori përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe derdhet mbi bazën e pagës referuese, mbi të cilën është llogaritur pensioni i parakohshëm, por në çdo rast brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të indeksuar me koeficientët e indeksimit të pensioneve.”.

Neni 3

Në paragrafin e tretë të nenit 16, shprehja “60 për qind” zëvendësohet me shprehjen “50 për qind”.

Neni 4

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Indeksi dhe rillogaritja

1. Përfitimet suplementare, që jepen sipas neneve 15, 17 e 21 të këtij ligji, indeksohen aq herë dhe në atë masë që indeksohen pensionet e përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Përfitimet suplementare, që jepen sipas neneve 12, 13, 19 e 23 të këtij ligji, rillogariten sa herë që ndryshon paga referuese, me të cilën është bërë llogaritja e këtyre përfitimeve.”.

Neni 5

Pika 2 e nenit 28 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ushtarakët, që plotësojnë kushtet për përfitim sipas këtij ligji dhe të cilëve, njëkohësisht, u lind e drejta të përfitojnë nga ligjet nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension” dhe nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave oficerë dhe nënoficerë, lundruer, të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare në pension”, kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet tyre.”.

Neni 6

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Pensioni suplementar për ushtarakët në pension para vitit 1991

1. Ushtaraku në pension, që ka përfituar pension pleqërie para vitit 1991, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ata që kanë përfituar pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfitojnë pension suplementar si ushtarak.

2. Masa e pensionit suplementar është e njëjtë me masën e pensionit të llogaritur në nenin 16 të këtij ligji.”.

Neni 7

(Shfuqizuar shkronjat "a" dhe "b" me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.2.2007)

Pas nenit 31 shtohet neni 31/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 31/1

Njohja si periudhë sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë

1. Për të gjithë ata ushtarakë, që kanë dalë në rezervë apo lirim dhe plotësojnë kushtet për pension pleqërie pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, periudha 1.10.1993 deri 31.12.1998 u njohet periudhë sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë, sipas kushteve të mëposhtme:

a) Shfuqizuar.

b) Shfuqizuar.

2. Mënyra, kushtet dhe kriteret e zbatimit të kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 4, 13, 14, 16 e 31/1 brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.”.

Neni 9

(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.2.2007)

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.